

---

**RREGULLORE NR. 2008/14**

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI VENDBANIMIN DHE VENDQËNDRIMIN TË  
MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në harmoni me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës, të datës 23 tetor 2007, lidhur me Ligjin mbi vendbanimin dhe vendqëndrimin të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 shtator 2007,

Duke ditur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë autorizimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas RKS KB 1244 (1999) apo kompetencat e tij të rezervuara dhe përgjegjësitë sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi vendbanimin dhe vendqëndrimin të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 02/L-121) që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje dhe bëhet i plotfuqishëm në datën e nënshkrimit, me kusht që:

(a) Fjala “Kosova” të zëvendësohet në tërë tekstin e Ligjit me fjalën “Kosovo”;

(b) Fjala “qytetar” të zëvendësohet në tërë tekstin e Ligjit me fjalën “banor i përhershëm”;

(c) Në nenin 4, termi “zyrat e gjendjes civile” zëvendësohen me termin “Zyra e gjendjes civile”;

(d) Në nenin 6.1 h), fjala “Shtetësi” zëvendësohet me termin “Banor i përhershëm/Shtetësi”;

(e) Neni 11 fshihet dhe nenet vijuese rinumërohen;

(f) Në nenin 12 a), fjalët “Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës” zëvendësohen me fjalët “dhe institucionet tjera qeveritare”, në nenin 12 e) fjalët “forcat e mbrojtjes, të shpëtimit dhe ndihmës” zëvendësohen me fjalët “Trupat Mbrojtëse të Kosovës” dhe neni 12 f) fshihet;

(g) Në nenet 17.1 dhe 17.4, termi “Zyra e kushteve civile” zëvendësohet me termin “Zyra e gjendjes civile”;

(h) Titulli i Kapitullit IV ‘Përcaktimi i dënimit (Gjobës)’ zëvendësohet me titullin “Sanksione administrative” dhe shprehja “kundërvajtje” fshihet në tërë tekstin e neneve 20 dhe 21.

Ndryshimet në (a), (b), (c), (d), (e), (f), (g) dhe (h) lart do të përfshihen në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

Nënshkruar sot, më 17 mars 2008.

Joachim Rücker  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm